

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Drejtësisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Programi i Qeverisë Shqiptare 2017-2021, pika 3.1 “Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re”.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	20.03.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	11.4.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[2018– MD- 01]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emirjana Dimo Emirjana.Dimo@drejtesia.gov.al Numër kontakti: +355 69 242 0014 Elsa.Gjini@drejtesia.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Problematikat e konstatuara në praktikë gjatë ekzekutimit të vendimeve penale dhe	

domosdoshmëria e ndërhyrjes shtetërore legislative:

1. Domosdoshmëria e harmonizimit të legjislacionit ekzistues me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, të hyrë në fuqi rishtazi, pasi ky i fundit përmban rregullime të posaçme lidhur me ekzekutimin e vendimit penal si dhe të cdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin.
2. Vështirësitë e hasura nga organet kompetente në zbatimin e dispozitave të ekzekutimit të masave mjekësore dhe aplikimit të tyre në praktikë. OJF-të vazhdimisht kanë shprehur shqetësimin lidhur me nevojën urgjente për ndërtimin e institucioneve të veçanta për këtë kategori personash me masë mjekësore, të cilët në mënyrë kategorike nuk duhen sistemuar në burgje, sepse ndaj tyre nuk ekziston asnjë masë dënimi penal me burgim. Trajtimi i këtyre grupeve individësh duhet të plotësojë standardet minimale të trajtimit në mënyrë njerëzore.¹
3. Domosdoshmëria e ndërhyrjes legislative për harmonizimin e legjislacionit aktual me dispozitat e projektligjit “Për shërbimin e provës” që është planifikuar të miratohet. Duke marrë në konsideratë që ligjvënësi synon të bëjë një ndërhyrje legislative duke miratuar projektligjin “Për shërbimin e provës”, është e nevojshme të rishihen dispozitat ligjore në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, konkretisht i gjithë Kreu II/1 i ligjit ku përcaktohen rregullime të detajuara lidhur me strukturën, organizimin dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës.
4. Vështirësitë dhe mungesa e efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve penale me gjysëm liri, përse i përket institucioneve ku vendosen të dënuarit.
5. Zvarritje të panevojshme dhe të pajustificueshme të procedurave për ekzekutimin e vendimit penal dhe mungesa e efektivitetit për shkak të mospërcaktimit të afateve kohore të prera të vendosura për mbarëvajtjen e procesit të ekzekutimit të vendimit penal nga ana e organeve kompetente me ligj.
6. Mungesa e parashikimeve ligjore lidhur me mënyrën e ekzekutimit të dënimit të heqjes së përgjegjësisë prindërore.
7. Zbatim jo i duhur i dispozitave lidhur me ekzekutimin e dënimit plotësues nxjerrja jashtë territorit, dënimit me konfiskim dhe ndalimit të ushtrimit të detyrave shtetërore.
8. Vështirësi në ekzekutimin e vendimit penal për personat juridikë, pasi nuk ka parashikime ligjore konkrete lidhur me mënyrën e ekzekutimit të të gjitha dënimeve dhe përcaktimin e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e tyre.
9. Mospërcaktimi qartë i përgjegjësisë administrative apo/dhe penale të organeve të përcaktuara me ligj (Prokuroria) për ekzekutimin e vendimeve penale, në rastet e mosekzekutimit të tyre në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale. Praktika ka vërtetuar se prokurorët pranë gjykatës së shkallës së parë ka raste që nuk zbatojnë me rigorozitet kërkesat e nenit 463 të Kodit të Procedurës Penale ku ata ngarkohen të marrin masa për ekzekutimin e vendimit dhe kur është rasti të kërkojnë kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi tjetër. Në të gjitha rastet zbatohet gjithashtu kërkesa e pikës 4 të nenit 463 të Kodit të Procedurës Penale që detyron

¹ Shih Raport Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisariatet e Policisë së Shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, korrik 2015-qershor 2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, faqe 59.

prokurorin për të njoftuar me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin menjëherë sa të ketë filluar ekzekutimi i vendimit.²

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektiva të përgjithshëm:

1. Rritja e efektivitetit në zbatimin e ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” nga subjektet që i adresohet ky ligj dhe njëkohësisht nga subjektet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, duke shmangur të gjitha problemet teorike dhe praktike të konstatuara në ekzekutimin e dënimeve alternative në vendin tonë si dhe përcaktimi ligjor i rolit dhe i vendit të Shërbimit të Provës në procesin penal ;
2. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit midis organeve përgjegjëse të parashikuara në ligj për ekzekutimin e vendimit penal;

Objektivat kryesore (SMART) të këtij propozimi janë:

1. Përcaktimi i përgjegjësisë administrative dhe/ose penale të organit procedues (prokurorit) në rastet e mosëkzekutimit të vendimit penal në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore, pa shkaqe të përligjura apo objektive.
2. Vendosja e të dënuarve në institucione të hapura, pra me regjim të hapur, duke përmirësuar procedurën e ndjekur për ekzekutimin e vendimit penal me gjysëm liri. Përcaktimi në projektligj se institucioni ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës.
3. Harmonizimi i ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” me rregullimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar rishtazi, për sa i përket ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe jo me burgim për të miturit.
4. Harmonizimi i ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” me parashikimet ligjore të projektligjit “Për Shërbimin e Provës”, për të shmangur “përplasjet” apo konfliktet ligjore lidhur me kompetencat e këtij institucioni. Ndryshimet ligjore që propozohen të bëhen në ligjin në fuqi të vijnë në përputhje me emërtimin e ri të degëve territoriale të zyrave të Shërbimit të Provës, në propozimin e ndryshimeve që do të sjellë projektligji i ri “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” që është në proces shqyrtimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.
5. Përcaktimi i organeve (organi i Prokurorisë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Policinë e Burgjeve) që realizojnë ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë dënime plotësuese si: nxjerrja jashtë territorit, dënimit me konfiskim dhe ndalimin e ushtrimit të detyrave shtetërore.
6. Përcaktimi i procedurës së ekzekutimit të dënimeve plotësuese, krahas dënimit kryesor për personat juridikë, duke identifikuar gjykatën në rastin e OJF-ve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit në rastin e shoqërive tregtare për përditësimin e regjistrimit, duke bërë edhe ndryshimet dhe

² Shih Raport studimor për vendimet e prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale dhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve penale, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014, faqe 29.

shënimet përkatëse.

7. Përcaktimi i lehtësirave dhe kushteve për ekzekutimin e *masave edukuese* për të miturit, duke parashikuar se sistemimi i tyre do të bëhet në qendra apo institucione publike ose private të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturve, në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.
8. Përcaktimi i afatit kohor 5 ditor për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për dënimet ndaj personave juridikë, nga momenti i marrjes së shkurtimit të vendimit gjyqësor penal nga ana e Gjykatës.
9. Përcaktimi i detyrimit të gjykatës që t'i dërgojë prokurorit kopjen e vendimit të shkurtuar brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës së vendimit që merr formë të prerë.
10. Rregullimin e procedurës së njoftimit të të miturit në konflikt me ligjin, duke parashikuar se në rast të ekzekutimit të dënimit me burgim, prokurori do t'i dërgojë urdhrin e ekzekutimit institucionit të paraburgimit, dhe në rast se i mituri ka qenë në gjendje të lirë ose në ngarkim të të cilit gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit ka pasur një masë sigurimi të ndryshme nga masa e sigurimit “arrest me burg”, urdhri do t'i dërgohet komisarit të policisë së vendbanimit ose vendqëndrimit të të dënuarit të mitur. Ndërsa, lidhur me dënimet me kufizim lirie të përcaktohet se Punonjësi i Shërbimit të Provës do të kryejë njoftimin në vendbanimin/vendqëndrimin e të dënuarit të mitur, duke mbajtur procesverbalin përkatës.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – status quo-ja– Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër si dhe nuk reflekton ndryshimet që po pëson legjislacioni në sistemin penitenciar në vendin tonë, si dhe në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Problematikat e evidentuara në përditshmërinë e punës së institucioneve të ngarkuara me ligj për zbatimin efektiv të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, nuk mund të zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera jolegislative, si për shembull, ndërmarrja e fushtave sensibilizuese apo ndërgjegjësimi për të gjithë subjektet që preken nga ligji (organet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale).

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar. Në parim, është opsioni i preferuar pasi nëpërmjet ndërhyrjes të ligjvënësit vetëm në dispozitat ligjore të cilat kanë hasur problematika të ndryshme përgjatë aplikimit dhe zbatimit të tyre në praktikë, do të mund të realizohet dhe plotësimi i të gjitha objektivave të përgjithshëm dhe specifike/konkretëne drejtim të përmirësimit të funksionimit të sistemit penitenciar në Shqipëri dhe harmonizimit të këtij ligji me parashikimet ligjore të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri të ekzekutimit të vendimeve penale, duke shfuqizuar ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, aktualisht në fuqi. Ky opsion nuk do të ishte shumë i pranueshëm, duke marrë në konsideratë faktin që ligji në tërësinë e tij i përgjigjet kërkesave të realitetit në Shqipëri, por në funksion të ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi, si dhe garantimit të veçantë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, është e nevojshme ndërhyrja legislative vetëm në disa pjesë të tij, pa bërë ndryshime strukturore apo thelbësore që lidhen me përmbajtjen e ligjit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar:

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

Ndikimet ekonomike:

Kosto në buxhetin e shtetit: Ndërhyrja shtetërore legislative nëpërmjet hartimit të disa ndryshimeve/shtesave në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” nuk sjell kosto/efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit dhe procesi i politikbërjes nëpërmjet miratimit të disa ndryshimeve/shtesave në këtë ligj zhvillohet për të mundësuar zbatimin efektiv, të drejtë dhe të shpejtë në kohë të procesit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje të plotë me të gjitha parashikimet ligjore.

Rritja e efektshmërisë të zbatimit të ligjit dhe forcimi i bashkëpunimit si dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, duke garantuar ekzekutimin e vendimit penal brenda afateve kohore të mirëpërcaktuara dhe moszvarritjen e procesit. Sic është përmendur dhe më sipër, ndërmarrja e kësaj nisme legislative, duke kërkuar ndërhyrjen në ligjin aktual në fuqi mbetet opsioni më i preferuar pasi nuk ka efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

Përfitimet në buxhetin e gjykatave:

Rritja e efektshmërisë në mënyrën e ekzekutimit të vendimit penal, duke qenë se synohet procedimi sa më i shpejtë i procesit të ekzekutimit të vendimit penal dhe ky objektivi specifik synohet të arrihet nëpërmjet dërgimit të vendimit gjyqësor të shkurtuar të Gjykatës të Prokurori, me qëllim kryerjen e procedurave të efektshme dhe të shpejta në kohë. Kjo zhvillohet pa kosto shtesë në buxhetin e gjykatave.

Ndikimet sociale:

-Rritja e efektshmërisë së ekzekutimit të vendimit penal për individët të dënuar me vendim penal me gjysëm liri në institucione me regjim të hapur (kategoria e të dënuarve me vendim penal me gjysëm liri).

-Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të masës mjekësore për personat e papërgjegjshëm, duke i lënë institucionet dhe trajtimin e këtyre personave të papërgjegjshëm në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi janë hequr nga ligji për të drejtat e të dënuarve institucionet e veçanta.

-Respektimi dhe garantimi i të drejtave të të miturve në ofrimin e mjediseve ose shërbimeve që mbështesin kohezionin e komunitetit apo në mënyrat e tjera që ndikojnë në cilësinë e jetës së të miturve, pasi synohet integrimi i tyre në qendra/institucione publike ose private të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor”.

Përpos kësaj nëpërmjet ndërmarrjes së nismës legislative synohet përmirësimi, rritja e efikasitetit dhe përcaktimi i procedurave të qarta për ekzekutimin e dënimeve me burgim, jo me burgim dhe dënimeve me gjobë për të dënuarit të mitur (përfitim social i drejtpërdrejtë).

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Ndryshimi i ligji 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, përmes ndërmarrjes së iniciativës ligjore për hartimin e disa ndryshimeve dhe shtesave, është opsioni që do të japë përfitime maksimale, pasi do të mundësohet arritjen e objektivave të përcaktuar më sipër me qëllim unifikimin e sistemit penitenciar në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë si dhe të përmirësimit të paketës penitenciare. Ndërhyrja në ligj është e domosdoshme pasi nevojitet harmonizimi i këtij ligji me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr.37/2017), të miratuar rishtazi si dhe me projektligjin “Për Shërbimin e Provës” që do të miratohet së shpejti. Theksojmë se opsioni 1, i përzgjedhur si opsioni më i mirë i mundshëm nuk sjell efekte shtesë në buxhetin e shtetit, duke mos e rënduar raportin e shpenzimeve, apo në buxhetin e institucioneve të cilat janë të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e vendimeve penale.

Përpos kësaj, miratimi i disa ndryshimeve dhe shtesave në ligjin aktual në fuqi mbetet opsion i preferuar për ndikimin/impaktin pozitiv në rregullimin e detajuar të të gjithë procedurës që ndiqet nga organet proceduese në ekzekutimin e dënimit penal, duke shmangur zvarritjen e procesit, kryesisht për shkak të moszbardhjes së vendimit të arsyetuar nga ana e Gjykatës brenda një afati të arsyeshëmsi dhe vonesat në sekretarinë gjyqësore, si dhe duke përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë trajtimin e të miturve duke u garantuar atyre mjedise të posaçme që kanë të gjithë infrastrukturën e përshtatshme për realizimin

e

nevojave/
kërkesave
specifike

që ato kanë, në ekzekutimin e masave edukuese.

2018	2019	2020	2021
------	------	------	------

Nëpërmjet miratimit të ndryshimeve dhe shtasave në ligjin aktual, përfitimi do të vihet re në mënyrë të drejtëpërdrejtë në forcimin e rregullave mbi procedurat mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, të efencës në shpejtësinë e zhvillimit të procesit të ekzekutimit të vendimeve penale nga momenti i përfundimit të procesit gjyqësor, lëshimit të urdhrat të ekzekutimit dhe dërgimin e të dënuarit në institucionin përkatës së vuajtjes së dënimit, si dhe në përmirësimin e procedurës së vënies në ekzekutim të vendimeve që përmbajnë dënime plotësuese, dytësore dhe urdhrave të tjera ligjore nga organet e caktuara me ligj për zbatimin e tyre e në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Zgjedhja e opsionit të fundit, pra miratimit të një ligji të ri rregullues nuk shfaqet i nevojshëm, pasi referuar edhe kontekstit historik, duke qenë se ligji aktual i është nënshtruar disa herë ndërhyrjeve legjislative, për t’iu përshtatur kërkesave të kohës në Shqipëri (*shih ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008 dhe ligjin nr. 80/2018 datë 15.11.2018*), ndërhyrja legjislative në këtë rast nëpërmjet realizimit të disa ndryshimeve dhe shtesave do të ishte opsioni më i mirë i mundshëm për harmonizimin e ligjit me ligjet e tjera (ndryshimet ligjore) të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi si dhe të përmirësimit të sistemit penitenciar. Përpos kësaj, kostot financiare, administrative, sociale për miratimin e një ligji të ri, duke anuluar tërësisht efektet juridike të ligjit aktual, jo vetëm që mund të jenë të larta, por shfaqen të panevojshme për realizimin e objektivave të identifikuar më sipër.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është:

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, duke miratuar projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

-----	-----	-----	-----
-------	-------	-------	-------

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsye pse?)

Kjo rubrikë do të plotësohet pas procesit të konsultimit publik.

Procesi i konsultimit publik nuk ka përfunduar ende.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” është publikuar në faqen zyrtare <http://www.konsultimipublik.gov.al> më datë 11.03.2019 dhe mbetemi në pritje të përfundimit të procesit të konsultimit me qytetarët.

Referuar ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, përfundon brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Për rrjedhojë , procesi i konsultimit publik për projektligjin e mësipërm është në realizim e sipër.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e projektligjit janë: Ministria e Drejtësisë, Ministri përgjegjës për rendin publik si dhe Prokurori i

Përgjithshëm. Këto institucione ngarkohen me ligj për zbatimin dhe mbikëqyrjen e mbarrëvajtjes së procesit të ekzekutimit të vendimit penal.

Ministri i Drejtësisë do të kujdeset për monitorimin e zbatimit të ligjit nga ana e institucionit të Shërbimit të Provës, për të cilin parashikohen detyrime ligjore në nismën ligjvënëse, lidhur me përcaktimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari me gjysmëliri; detyrime lidhur me ekzekutimin e dënimeve jo me burgim për të miturit të dënuar dhe njoftimin e tyre, duke vepruar në përputhje edhe me parashikimet e bëra në ligjin nr. 37/2017.

Prokuroria do të kujdeset për mbikëqyrjen dhe monitorimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal, duke filluar që nga respektimi i afateve që do të përcaktohen (5 ditore) për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për personat juridikë, dërgimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal që përmban dënim me burgim për të mitur, institucioneve të paraburgimit, brenda një afati sa më të arsyeshëm, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për kalimin e të miturit në IEVP-në për të mitur.

Rol të rëndësishëm mbikëqyrës dhe monitorues do të ketë edhe Ministria përgjegjëse për rendin publik lidhur me ekzekutimin nga ana e Policisë së Shtetit të vendimeve me dënim me burgim për personat në gjendje të lirë, si dhe dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 2,3,7,8 dhe 10 të nenit 30 të Kodit Penal, i ndryshuar, gatishmërinë e Policisë së Shtetit për të mbështetur veprimet e policisë gjyqësore, ushtarake dhe policisë së burgjeve për ekzekutimin e vendimeve penale, që kanë marrë formë të prerë, apo që kanë ekzekutim të menjëhershëm.

Monitorimi në nivel makro do të realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse monitoruese në Ministrinë e Drejtësisë, në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe në Ministrinë përgjegjëse për rendin publik, të cilët do të marrin masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e ligjit.

Këto struktura të ngritura pranë institucioneve përgjegjëse do të hartojnë planin vjetor të planifikuar të inspektimit, mbi bazën e të cilit do të kryhet monitorimi dhe vlerësimi i performancës së organeve proceduese për ekzekutimin e vendimit penal.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

- *Jepni kontekstin e politikës*

Në kontekstin e sistemit të drejtësisë shqiptare dhe më konkretisht atë të sistemit penitenciar, ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” është miratuar më datë 21.04.1998, shpallur me dekretin nr.2079, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, faqe 415.

Ky ligj i është nënshtruar ndërhyrjes legjislative dy herë, konkretisht ndryshimet e para në këtë ligj janë bërë me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, i shpallur me dekretin nr.5977, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr.190, faqe 9402; dhe ndryshimet e tjera në këtë ligj janë bërë me ligji nr.80/2018, datë 15.11.2018, i shpallur me dekretin nr. 10979, datë 27.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr.172.

Ndryshimet legjislative të miratuara dhe hyrë në fuqi kanë përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe kanë forcuar bashkëpunimin e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit penal.

Megjithatë, në kuadër të Reformës në Drejtësi si dhe në kuadër të reformës së sistemit penitenciar është parë e nevojshme dhe e domosdoshme ndërhyrja në këtë ligj për përmirësimin e zbatimit të tij në funksion edhe të ndryshimeve ligjore që po pëson edhe legjislacioni mbi sistemin e Policisë së Burgjeve, të Shërbimit të Provës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm si dhe mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve në sistemin e burgjeve.

Gjithashtu Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (ligji nr.37/2017) ka parashikuar koncepte të reja dhe në disa dispozita përcaktohet që do të rritet volumi i punës së institucioneve që ekzekutojnë vendimet penale. Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe hyrja në fuqi e tij sjell nevojën dhe domosdoshmërinë e reflektimit dhe harmonizimit të këtyre parashikimeve edhe në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Përpos kësaj, duhet të shihen të gjitha parashikimet ligjore që kanë të bëjnë me strukturën, funksionimin si dhe veprimtarinë e Shërbimit të Provës, të përcaktuara në këtë ligj, në funksion të harmonizimit të tij me projektligjin “Për Shërbimin e Provës” që do të miratohet së shpejti.

Problemi në shqyrtim

- ***Përshkruani natyrën e problemit.***

Janë identifikuar disa probleme gjatë zbatimit në praktikë të ligjit si dhe ekzekutimit të vendimeve penale deri më sot. Konkretisht,

1. Vështirësi në zhvillimin e procedurës që ndiqet për ekzekutimin e vendimeve penale;
2. Vështirësi në bashkëpunimin e organeve të prokurorisë, policisë së shtetit, shërbimit të provës si dhe sistemit të burgjeve, duke e pasur të vështirë koordinimin e detyrave ndërmjet tyre. Kjo ka sjellë edhe probleme në drejtëm të identifikimit të organit procedues përkatës që duhet të mbajë përgjegjësi administrative ose/dhe penale, në rast të moszbatimit drejt të dispozitave ligjore, pa shkaqe të arsyeshme, të justifikuara dhe objektive;
3. Probleme në respektimin e afateve për fillimin dhe përfundimin e procedurës së ekzekutimit;
4. Vështirësi në ekzekutimin e masave mjekësore në burgje;
5. Vështirësi në ekzekutimin e dënimit plotësues të heqjes së përgjegjësisë prindërore;
6. Paqartësi dhe moskoordinim në mënyrën e ekzekutimit të dënimeve me burgim, jo me burgim dhe me gjobë për të miturit për shkak të miratimit dhe hyrjes në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe mosrakovit të parashikimeve ligjore;
7. Vështirësi në ekzekutimin e vendimeve penale që lidhen me subjekte juridike (dënimeve plotësuese).

- ***Identifikoni shkaqet e problemit.***

Problematikat e hasura përgjatë zbatimit të ligjit aktual në fuqi, vijnë kryesisht për shkak të miratimit të ndryshimeve ligjore në kuadër të reformës në drejtësi, pasi është e domosdoshme

harmonizimi i ligjit me dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar rishtazi dhe me dispozitat e ligjit “Për Shërbimin e Provës” që pritet të miratohet.

Gjithashtu, përgjatë zbatimit të ligjit janë vënë re probleme lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, pasi gjykata nuk e dërgon vendimin gjyqësor të zbardhur brenda një afati të arsyeshëm, por nga ana tjetër është vënë re që edhe prokurori nuk aktivizohet vetë në një kohë sa më të shkurtër dhe pa vonesa, për të marrë vendimin gjyqësor në mënyrë që të procedojë më tej me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit.

Përpos sa më sipër, problematikat në ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë dënime si nxjerrja jashtë territorit, dënimit me konfiskim dhe ndalimit të ushtrimit të detyrave shtetërore, apo dënime penale për subjektet juridike, vijnë pasi në ligj nuk janë të përcaktuara qartë organet kompetente për ekzekutimin e vendimeve penale, të cilat kanë detyrimin e garantimit të mbarëvajtjes së procesit.

Përshkruani shtrirjen e problemit.

Problematikat e identifikuara që çojnë në nevojën e ndërmarrjes së iniciativës ligjore, përmes ndërhyrjes së qeverisë, janë të natyrës që nuk mund të zgjidhen përmes rrugëve të tjera jolegjislative. Përgjatë aplikimit të ligjit në fuqi dhe akteve ligjore të nxjerra në zbatim të tij janë hasur vështirësi nga organet kompetente në zbatimin e dispozitave të ekzekutimit të masave mjekësore, masave edukuese për të miturit të dënuar dhe aplikimit të tyre në praktikë. OJF-të vazhdimisht kanë shprehur shqetësimin lidhur me nevojën urgjente për ndërtimin e institucioneve të veçanta për këtë kategori personash me masë mjekësore, të cilët në mënyrë kategorike nuk duhen sistemuar në burgje, sepse ndaj tyre nuk ekziston asnjë masë dënimi penal me burgim.

Përpos kësaj, janë hasur vështirësi edhe për ekzekutimin me efektivitet të vendimeve penale me gjysëm liri, përsa i përket institucioneve ku vendosen të dënuarit. Është vënë re gjithashtu vonesë e paarsyeshme dhe e papërligjur e ekzekutimit të vendimit penal për personat juridikë, për shkak të dy arsyeve, së pari, për shkak të vonesës së gjykatës në nxjerrjen e vendimit të arsyetuar brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar, dhe së dyti, për shkak të vonesës së organit të Prokurorisë në nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm dhe objektiv.

- ***Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.***

Grupet e prekura nga ky problem janë subjektet (fizike dhe juridikë), të mitur dhe madhorë, ndaj të cilëve janë marrë vendime gjyqësore penale përfundimtare, të formës së prerë ose jopërfundimtare (masa sigurimi) apo/dhe urdhërime të tjera ligjore.

- ***Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.***

Problematikat e hasura, të identifikuara si më sipër, mund të trajtohen përmes ndryshimit të politikave, duke ndërmarrë rrugën e ndryshimeve ligjore, pra ndërhyrjes shtetërore legjislative, pasi është e domosdoshme ndër të tjerash, harmonizimi i ligjit me dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe kjo nuk mund të realizohet nëpërmjet rrugëve apo mjeteve të tjera jo legjislative.

Natyra e problemit është e tillë që kërkon ndërhyrje legjislative. Ndërhyrja është e nevojshme pasi problemi nuk mund të zgjidhet me mjete të tjera të ndryshme nga legjislacioni.

Problemet e identifikuara do të zgjidhen nga legjislacioni i propozuar, duke orientuar situatën në drejtimin e dëshiruar, që konsiston në ekzekutimin e vendimeve penale, sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe brenda afateve të arsyeshme ligjore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje qeveria synon të rrisë profesionalizmin dhe integritetin e të gjithë stafit të sistemit të Shërbimit të Provës, i cili mbështet dhe mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative, si dhe mbështetjen e nevojshme infrastrukturore me qëllim krijimin e lehtësive dhe ofrimin e mundësive për të zhvilluar veprimtarinë e këtij institucioni dhe institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në mënyrë efikase. Pa ndërhyrjen e qeverisë dhe ndërmarrjen e kësaj politike rregullatore nuk do të mundësohej që institucioni i Shërbimit të Provës t'i përgjigjej nevojave dhe ndryshimeve rrënjësore të sistemit dhe objektivave të qeverisë shqiptare, për një sistem drejtësie të pavarur, eficient, sa më profesional dhe të aksesueshëm nga qytetarët.

Ndërhyrja e qeverisë është gjithashtu e justifikuar për shkak të rikonceptimit të sistemit të drejtësisë shqiptare, si dhe në sajë të ndryshimeve dhe miratimeve të ligjeve të reja në kuadër të Reformës në Drejtësi që qeveria shqiptare ka ndërmarrë, të cilat diktojnë nevojën e parashikimeve të reja ligjore me qëllim përmbushjen e objektivave të reformës në drejtësi, e parë edhe në aspektin e përmbushjes së objektivit strategjik të vendit tonë, sic është integrimi në Bashkimin Europian.

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*

Për trajtimin e duhur dhe adresimin e plotë të problemit, është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë shqiptare për të ndërmarrë iniciativën ligjvënëse, në kuptim të nenit 81/1 të Kushtetutës, për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin përfundimtar të projektligjit në Kuvend, duke sjellë situatën e dëshiruar në sistemin penitenciar dhe reduktimin e problematikave të hasura në aspektin ligjor.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje legjislative synohet përmbushja e objektivave afatgjatë të përcaktuara në Programin e Qeverisë Shqiptare 2017-2021, konkretisht në pikën 3.1 “*Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re*”, ku parashikohet se:

“Pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare, burgjet dhe paraburgimet, si dhe shërbimi i provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale.

Reformim rrënjësor do të pësojë mënyra e rekrutimit të stafit policor dhe atij civil, për të shmangur njëherë e mirë emërimet politike, si dhe rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të stafit të këtij sistemi”.

Nëpërmjet kësaj iniciative ligjore, janë adresuar çështje të cilat bëjnë të mundur realizimin konkret të objektivit të mësipërm, me qëllim rritjen e efektivitetit të institucioneve në ekzekutimin e vendimeve penale. Konkretisht, nëpërmjet projektligjit që synohet të hartohet është vlerësuar të adresohen çështje të tilla si më poshtë vijon:

1. Përgjegjësia administrative dhe/ose penale e prokurorit në rastet kur nuk ekzekuton vendimin në përputhje me përmbajtjen e tij;
2. Shtimi i detyrave të Policisë së Shtetit për ekzekutimin e dënimeve plotësuese të parashikuar në pikën 2 dhe 10 të Kodit Penal, konfiskim dhe heqja e përgjegjësisë prindërore.
3. Dërgimi i vendimeve nga Gjykata në formë të shkurtuar te prokurori, brenda një afati sa më të shpejtë kohor me qëllim procedimin për ekzekutimin e vendimit pa pritur zbardhjen e vendimit.
4. Përmirësimi i ekzekutimit të vendimit me gjysëm liri për shkak se në ligjin për të drejtat e të dënuarve është parashikuar vendosjen e tyre në institucione të hapura.
5. Harmonizimi i ligjit duke hequr Kreun II/1, të titulluar “*Shërbimi i provës*”, pasi kompetencat e institucionit të Shërbimit të Provës janë parashikuar në ligj të veçantë.
6. Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të dënimeve për të mitur, në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
7. Përmirësimi i dispozitave për ekzekutimin e dënimit plotësues nxjerrja jashtë territorit, dënimit me konfiskim dhe ndalimit të ushtrimit të detyrave shtetërore.
8. Shtimi i një dispozite në lidhje me ekzekutimin e dënimit plotësues për “heqjen e përgjegjësisë prindërore”.
9. Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të masës mjekësore, duke i lënë institucionet dhe trajtimin e këtyre personave të papërgjegjshëm në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak se janë hequr nga ligji për të drejtat e të dënuarve institucionet e veçanta.
10. Përmirësimi i mënyrës së ekzekutimit të vendimit penal për personat juridikë, duke përcaktuar mënyrën e ekzekutimit të të gjitha dënimeve dhe organet përgjegjës për ekzekutimin e tyre.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
1. Procedura të shpejta dhe efikase në kohë për mbarëvajtjen dhe garantimin e zhvillimit të procesit të ekzekutimit të vendimit penal, brenda afateve ligjore të mirëpërcaktuara.
 2. Rritja e efektivitetit në zbatimin e ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, i ndryshuar nga subjektët përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve penale.
 3. Rritja e profesionalizmit gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me ligj të organit procedues dhe mbajtjen e përgjegjësisë administrative dhe/ose penale nga ana e këtij të fundit në rastet e mosekzekutimit të vendimit në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore.
 4. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit midis organeve përgjegjëse të parashikuara në ligj për ekzekutimin e vendimit penal;
 5. Përmirësimi i procedurës së ndjekur për ekzekutimin e vendimit penal me gjysëm liri duke parashikuar vendosjen e të dënuarve në institucione të hapura.
-

6. Harmonizimi i ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar rishtazi.
7. Harmonizimi i ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” me rregullimet ligjore të projektligjit “Për Shërbimin e Provës”, për të shmangur “përplasjet” ligjore.
8. Rritja e efektivitetit në ekzekutimin e vendimit penal për personat juridikë, përmes identifikimit të organeve përgjegjëse për ekzekutimin e tyre.
9. Zbatimi i drejtë i dispozitave lidhur me ekzekutimin e dënimit plotësues nxjerrja jashtë territorit, dënimit me konfiskim dhe ndalimit të ushtrimit të detyrave shtetërore.
10. Krijimin e lehtësirave ligjore për organet proceduese në zbatimin e dispozitave të ekzekutimit të masave mjekësore.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – status quo-ja – Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legjislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër dhe nuk reflekton ndryshimet që po pëson legjislacioni në sistemin penitenciar në vendin tonë në kuadër edhe të reformës në sistemin e drejtësisë. Problematikat e evidentuara në përditshmërinë e punës së institucioneve të ngarkuara me ligj për zbatimin efektiv të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, nuk mund të zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera si për shembull, ndërmarrja e fushatave sensibilizuese apo ndërgjegjësimi për të gjithë subjektet që preken nga ligji, apo me cdo mjet tjetër që nuk i përket rrugës legjislative. Po kështu, jemi në kushtet ku problematikat nuk mund të zgjidhen si rezultat i një rregullimi ose ligji që hyn në fuqi gjatë fazës së planifikuar të zbatimit të ligjit të ri. Natyra e problematikave të evidentuara është e tillë që nuk mund të adresohen si dhe të kenë zgjidhje efektive, nëse nuk ndërmerret iniciativa ligjvënëse, pasi është e domosdoshme ndërhyrja urgjente fillimisht për harmonizimin e ligjit me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe me ligjin “Për Shërbimin e Provës”.

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

Në parim, është opsioni i preferuar pasi nëpërmjet ndërhyrjes të ligjvënësit në ato dispozita ligjore, të cilat kanë pasur problematika të ndryshme përgjatë aplikimit të tyre në praktikë, do të mund të realizohet dhe plotësimi i të gjitha objektivave në drejtim të përmirësimit të funksionimit të sistemit penitenciar në Shqipëri. Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, duke miratuar një projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” është opsioni që do të japë përfitime maksimale, duke tejkaluar edhe kostot e mundshme që mund të shfaqen, pasi ky opsion do të mundësojë arritjen e objektivave specifike, të përcaktuar në pjesën e parë.

Nëpërmjet këtij opsioni do të mund të realizohet harmonizimi i këtij ligji me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur për të garantuar mbrojtjen e veçantë të të miturve dhe të drejtave të tyre, si dhe me projektligjin “Për Shërbimin e Provës” që do të

miratohet së shpejti. Theksojmë se opsioni i zgjedhur nuk sjell efekte shtesë në buxhetin e shtetit, duke mos e rënduar raportin e shpenzimeve apo buxhetin e institucioneve që ekzekutojnë vendimet penale.

Përpos kësaj, miratimi i ndryshimeve dhe shtesave në ligjin aktual mbetet opion i preferuar për ndikimin/impaktin pozitiv në rregullimin e të gjithë procedurës që ndiqet nga organet proceduese në ekzekutimin e dënimit penal, duke shmangur zvarritjen e procesit me afate jo të përcaktuara në mënyrë eksplicite si dhe duke përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë trajtimin e të miturve duke u garantuar atyre mjedise të posaçme dhe të përshtatshme në përputhje me nevojat specifike që ato kanë.

Nëpërmjet miratimit të ndryshimeve dhe shtesave në ligjin aktual përfitimi do të vihet re në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e rregullave mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, të efencës në shpejtësinë në ekzekutimin të vendimeve penale, si dhe në përmirësimin e procedurës së vënies në ekzekutim të vendimeve penale dhe urdhrave të tjera ligjore nga organet e caktuara me ligj për zbatimin e tyre.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri të ekzekutimit të vendimeve penale, duke shfuqizuar ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, aktualisht në fuqi. Vlerësojmë se ky opion nuk do të ishte shumë i pranueshëm, duke marrë në konsideratë faktin që ligji në terësinë e tij i përgjigjet kërkesave të realitetit në Shqipëri, referuar edhe faktit që i është nënshtruar ndryshimeve ligjore me ligjin nr. 80/2018 datë 15.11.2018, por në kuadër të ndryshimeve ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi, ndërhyrja legjislative në këtë rast nëpërmjet realizimit të disa ndryshimeve dhe shtesave, të cilat nuk lidhen me ndryshime thelbësore dhe strukturore të ligjit, është i domosdoshëm në kuadër të harmonizimit të tij me ligjet e tjera (ndryshimet ligjore).

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*

Grupet e prekura janë subjektet (fizike dhe juridikë), të mitur dhe madhorë, ndaj të cilëve janë marrëvendime gjyqësore penale përfundimtarë, të formës së prerë ose jopërfundimtare (lidhur me masat e sigurimit) apo/dhe urdhërime të tjera ligjore. Gjithashtu nga rregullimet e reja ligjore preken edhe organet si: Prokuroria, Shërbimi i Provës, Policia e Burgjeve.

- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

- o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Projektligji i propozuar nuk sjell ndikime mbi konkurrencën apo mbi bizneset.

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

- *Përmblihdni vlerësimin e opsioneve:*

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura dhe ndikimet.

Për të dënuarit e mitur dhe madhorë, përfitimi do të jetë i drejtpërdrejtë.

Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve penale, duke përfshirë efikasitetin në ekzekutimin e masave mjekësore (në qendra spitalore), të dënimit plotësues të heqjes së përgjegjësisë prindërore (rregullimi konkret me ligj), nxjerrjes jashtë territorit, konfiskimit të pasurisë.

Për personat juridikë do të përmirësohet ekzekutimi i vendimeve penale, duke përcaktuar konkretisht organet pranë të cilave bëhet publikimi i vendimit për mbarimin e personave juridike dhe kryerja e shënimeve në regjistrat përkatës. (përfitim social)

Të miturit ndaj të cilëve janë vendosur masa edukuese do t'ju mundësohet e gjithë infrastruktura e nevojshme për kryerjen e dënimit penal, në përputhje edhe me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ekzekutimi i masave edukuese do të kryhet në qendra apo institucione publike ose private të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Të miturit nuk do të vuajnë dënimin të përcaktuar në pjesën urdhëruese të vendimit penal në IEVP për madhorë, por në IEVP për të mitur, pasi organet kompetente (institucioni i paraburgimit, komisariati i policisë së vendbanimit ose vendqëndrimit të të dënuarit të mitur) të marrin të gjitha masat e duhura, për kalimin e të miturve në këto institucione.



Njëkohësisht do të përcaktohet në mënyrë konkrete mënyra e njoftimit të të miturit për vendimet që parashikojnë burgim, të vendimeve që nuk parashikojnë kufizimin e lirisë, si dhe vendimeve me gjobë të dhënë ndaj tyre.

Gjithashtu, përfitimi nga miratimi i ndryshimeve ligjore do të vihet re edhe në drejtim të detyrave të **prokurorit**, pasi lehtësohet puna e këtij organi procedues në drejtim të nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm, pas marrjes së vendimit gjyqësor të shkurtuar. Për shembull, për personat juridikë, propozohet që për dënimet ndaj tyre urdhri i ekzekutimit të nxirret brenda 5 ditëve nga marrja e shkurtimit të vendimit gjyqësor, në mënyrë që të vijojë më tej procedura e ekzekutimit të vendimit penal brenda afateve ligjore të arsyeshme dhe të shpejta, duke mos pritur, siç është bërë deri më sot, zbardhjen e vendimit të arsyetuar të Gjykatës, ku kjo e fundit si dhe sekretaritë gjyqësore, për shkak të mbigarkarkesës, shpeshherë kanë devijuar nga afatet ligjore për arsyetimin e vendimit gjyqësor penal.

Përfitimi kryesor i drejtpërdrejtë ekonomik :

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit dhe nuk prek ekonominë e subjekteve të cilave iu drejtohet projektligji i supozuar (të dënuarit madhorë dhe të mitur), pasi nuk parashikohen tarifa monetare për ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të subjekteve. Në këto kushte miratimi i projektligjit të supozuar, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mënyrës së ekzekutimit të vendimeve penale si dhe ndikimin pozitiv në trajtimin e të miturve dhe garantimit të drejtave të tyre gjatë ekzekutimit të vendimeve penale, është opsion i preferuar, për shkak të përmirësimit të sistemit penitenciar në vendin tonë.

Ndikime sociale

Projektligji i propozuar sjell impakt social për target grupet e mësipërme, të cilat preken nga ky projektligj. Konkretisht, nëpërmjet ndryshimeve/shtesave ligjore, do të përmirësohen kushtet e trajtimit të të miturve në ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë masa edukuese duke u vendosur në qendra/ institucione që sigurojnë përmbushjen e nevojave të vecanta të tyre. Ndikimi social vihet re edhe në drejtim të përmirësimit të ekzekutimit të masave mjekësore në qendrat spitalore, duke pasur parasysh shqetësimin e shoqërisë shqiptare për trajtimin e duhur të personave të papërgjeshëm.

Gjithashtu forcohet besimi i **publikut/shoqërisë** në sistemin e burgjeve (impakt social jo i drejtpërdrejtë), pasi në projektligj parashikohet përgjegjësia administrative dhe/ose penale në rastet e mosekzekutimit të vendimit në përputhje me përmbajtjen e tij ose mosekzekutimin e tij brenda afateve ligjore. Kësisoj, lind nevoja për forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të detyrave midis organeve përgjegjëse (prokurorisë, komisariatit, shërbimit të provës, gjykatës, institucionit të paraburgimit, organeve përmbartimore shtetërore/private) në ekzekutimin e dënimeve penale.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*

Opsioni i preferuar është opsioni 1 (ndryshimi i ligjit 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar).

Analiza me shumë kriterë

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 –*status quo*-ja – Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legislative.

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri të ekzekutimit të vendimeve penale, duke shfuqizuar ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, aktualisht në fuqi.

Identifikimi i kriterëve që tregojnë arritjen e objektivit kryesor të përmirësimit të sistemit penitenciar në vendin tonë:

-Harmonizimi i ligjit në fuqi me parashikimet ligjore të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

-Efektiviteti i procesit të ekzekutimit të vendimit, në garantimin e të drejtave të të miturve të dënuar me vendim penal, duke i mundësuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme që iu përgjigjet kërkesave dhe nevojave specifike të gjithsecilit (përmirësimi i ekzekutimit të masave edukuese, procesit të njoftimit të dënimit dhe vendosjes së tyre në institucione të posaçme etj)

-Efektiviteti i ekzekutimit të vendimeve penale për personat juridikë.

-Efektiviteti i procesit të ekzekutimit të vendimit penal duke lëshuar urdhrin e ekzekutimit pa pritur zbardhjen e vendimit të arsyetuar plotësisht (brenda një afati të arsyeshëm dhe të përcaktuar)

-Shkalla e performancës: nga 0-4 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 4 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Efektiviteti i procesit të ekzekutimit të vendimit, në garantimin e të drejtave të të miturve të dënuar me vendim gjyqësor.	4	0(0)	4(16)	3(12)
-Harmonizimi i ligjit në fuqi me parashikimet ligjore të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.	3	0(0)	4(12)	2(6)
Efektiviteti i ekzekutimit të vendimeve për personat juridikë.	1	1(1)	4(4)	2(2)
Efektiviteti i procesit të ekzekutimit të vendimit penal duke lëshuar urdhrin e ekzekutimit, pa vonesë, brenda një afati	2	2(4)	4(8)	2(4)

të arsyeshëm dhe të përcaktuar.				
Kostot	4	6(24)	4(16)	2(8)
Pikët		29	56	32

- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1, pra miratimi i disa ndryshimeve/shtesave në ligjin aktual është i preferuar për shkak se objektivat e përcaktuara më sipër që synon të arrijë ky projektligj plotësohen më së miri, duke i dhënë zgjidhje efektive të gjitha problematikave të identifikuara.

Duke mbajtur në konsideratë qëllimin e garantimit të ekzekutimit të drejtë dhe të njëjtë të vendimeve gjyqësore në respektim të parimit të lirisë dhe sigurisë së personit, rritjen e efektshmërisë së sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale, nëpërmjet projektligjit do të arrihet harmonizimi i ligjit me dispozitat ligjore të Drejtësisë Penale për të Mitur, duke garantuar trajtimin e të miturve të dënuar në përputhje me nevojat specifike të gjithsecilit.

Nëpërmjet ndryshimeve ligjore që propozohen të bëhen, do të përmirësohet ekzekutimi i masave mjekësore si dhe i dënimeve plotësuese si konfiskimi i pasurisë, heqja e përgjegjësisë prindërore si dhe nxjerrja jashtë territorit.

Gjithashtu, nisur nga qëllimi për plotësimin e mangësive të konstatuara dhe të cilësuar si të nevojshme për realizimin e një procesi të rregullt ligjor, ndërhyrja legjislative është e domosdoshme për shmangien e zvarritjes së procesit, duke vendosur afate të arsyeshme për dhënien e vendimit gjyqësor të shkurtuar si dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit³, për të vijuar më tej me dërgimin e të dënuarit në institucionin përkatës.

Nisma legjislative synon edhe përmirësimin e procedurës së njoftimit të të miturit/përfaqësuesit të tij ligjor, në rastet kur i mituri është dënuar me vendim jo me burgim, si dhe në rastet e dënimeve me burgim, ku i mituri është në gjendje të lirë.

Përzgjedhja e opsionit të 1 (rregullator) është më i miri në drejtim të përfitimeve dhe nivelit të parametrave që kërkohen të arrihen, në raport me opsionin 2, që ka të bëjë me hartimin dhe miratimin e një ligji të ri në fushën e ekzekutimeve penale, pasi në këndvështrimin e çështjes së problematikave të konstatuara, nuk është e nevojshme hartimi i ndryshimeve ligjore strukturore dhe përmbajtësore të ligjit, të cilat do sillnin shfuqizimin e ligjit aktual në fuqi.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin dhe

³ Problematika e nxjerrjes me vonesë së urdhrit të ekzekutimit është konstatuar edhe në raportin vjetor “Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit 1 janar-31 dhjetor viti 2017”, prill 2018;Tiranë.

monitorimin e projektligjit janë: Ministria e Drejtësisë, Ministri përgjegjës për rendin publik si dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Këto institucione ngarkohen me ligj për zbatimin dhe mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së procesit të ekzekutimit të vendimit penal dhe Monitorimi në nivel makro do të realizohet nga strukturat përkatëse përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe në Ministrinë përgjegjëse për rendin publik, qw do tw kenw nw detyrwn e tyre mbikëqyrjen e zbatimit tw ligjit dhe ekzekutimin e vendimeve penale qw pwrmbajnw dwnime plotwsyese, krahas dwnimit kryesor, sipas procedurave ligjore dhe brenda afateve tw arsyeshme.

Nw rastin e mosrespektimit tw ligjit nga organet proceduese tw pwraktuara nw ligj dhe mozbatimit tw urdhwrimeve ligjore gjatw procedurws sw ekzekutimit tw vendimit penal, institucionet mbikëqyrwse do tw marrin masa qw lidhen me vwnien nw pwrgegjiwsi administrative dhe/ose penale tw subjekteve pwrgegjiws, si pasojw e mosekzekutimit tw vendimit nw pwrputhje me pwrmbajtjen e tij, ligjin dhe aktet e tjera ligjore nw fuqi.

Nuk vihen re pengesa ligjore apo institucionale për zbatimin e opsionit të zgjedhur si më i miri i mundshëm.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Për të matur arritjen e qëllimeve të përcaktuara më sipër apo progresin e vazhdueshëm drejt tyre, mund të përdorim si kritere matës:

- Raporti i numrit të lëshimit të udhrave për ekzekutim dhe vendimet e ekzekutuara në të gjitha rrethet e Republikës së Shqipërisë brenda harkut kohor të 1 viti.

Më poshtë, në funksion të ilustrimit të këtij kriteri, janë paraqitur të dhëna statistikore për numrin e lëshimit të udhrave të ekzekutimit, vendimet e ekzekutuara dhe të paekzekutuara për periudhën 2015-2017 dhe vihet re që numri i vendimeve të paekzekutuara përgjatë kësaj periudhe nuk është i ulët.

Viti	Numri i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit ⁴	Vendime të ekzekutuara	Vendime të paekzekutuara	Numri i vendimeve mbartur pa ekzekutim	Total
2015	7741	3317	3700	2470	6170
2016	6039	2656	3437	2750	6187
2017	5350	3134	2052	1738	3790

⁴ Shih Vjetari Statistikor 2015, 2016, 2017; Ministria e Drejtësisë.

- Efektiviteti i mbikëqyrjes së zbatimit të dënimeve alternative nga Shërbimi i Provës në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Theksojmë që numri relativisht i lartë i rasteve të mosekzekutimit të dënimeve alternative ndikon negativisht në tërë sistemin e drejtësisë penale veçanërisht në besueshmërinë ndaj Shërbimit të Provës si institucioni që mbikëqyr dënimet alternative. Kjo është një nga arsyt kryesore që justifikon ndërhyrjen legislative në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale.

Lloji i dënimeve ⁵	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Neni 59 i KP “Pezullimi”	4798	4460	4904
Neni 59/a i KP “Qëndrimi në shtëpi”	92	74	85
Neni 64 i KP “Lirimi me kusht”	84	101	172
Neni 63 i KP “Punë në interes publik”	974	938	884
Neni 58 i KP “Gjysmëliria”	4	4	1
Total	5952	5577	6046

- Raporti i numrit të çështjeve të ekzekutuara tërësisht nga shërbimi përmbarimor dhe çështjeve në ekzekutim e sipër në harkun kohor të 1 viti.

Çështjet sipas viteve ⁶	Të ekzekutuara tërësisht	Në ekzekutim
Viti 2015	9260	27282
Viti 2016	8864	28283
Viti 2017	7664	30796

Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së këtij institucioni do të realizohet në bazë të një plani vjetor të planifikuar të inspektimit nga struktura përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministri përgjegjës për rendin publik, si dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

⁵ Shih Vjetari Statistikor 2015, 2016, 2017; Ministria e Drejtësisë.

⁶ Shih Vjetari Statistikor 2015, 2016, 2017; Ministria e Drejtësisë.

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			